



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	19.07.2023	26.07.2023	2023/0471

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.07.2023, **OE "EJONA " SH.P.K."**- Pejë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0471, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE"UPLIFT L.L.C"**- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Instalimi dhe rregullimi i lifteve te objekteve te Komunës"** me nr. të prokurimit: **"616-23-3831-5-2-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **180,000.00 €.**

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë.....27.04.2023;

Procesverbali i hapjes së ofertave.....19.05.2023;

Njoftimi mbi vendimin e AK-së.....14.06.2023;

Kërkesa për rishqyrtim19.06.2023;

Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim.....26.06.2023;

Ankesa ne OSHP.....04.07.2023;

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka shkelur këto dispozita:

Pretendimi 1&2) -Neni 51

Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes -Neni 52

Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës -Neni 56

Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Interpretim nga KRPP:

Në përputhje me paragrafin 1 të nenit 51 të LPP-së autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë kriteret e përzgjedhjes në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë që një OE duhet të plotësojë për të konsideruar si kualifikuar (i përgjegjshëm). "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për të përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim.

-UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

iii. Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):

-iv. Shënim për evidencën dokumentuese:

- Periudha kohore e historikut për evidencën dokumentuese nën kërkesat e

përshtatshmërisë kalkulohet nga data e publikimit të Njoftimit të Kontratës ose në

rast të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, data kur ftesa për pjesëmarrje është dërguar.

Pretendimi 3)

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK

duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Mungon çmimi - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrativ

Lista e çmimeve nuk është plotësuar - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrativ

Argumenti 1)

AK, ka shkelur dispozitat ligjore të lartepërmendura me shpalljen e fituesit të OE UP LIFT. Ky OE, nuk ka përmbushur kërkesat e DT dhe të Njoftimit për kontratë, përkatësisht:

1) Në DT dhe në Njoftimin për kontratë, AK ka kërkuar:

2. Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme

c. **3 teknikë të ndërtimtarisë** Minimumi 3 vite përvojë pune në punë.

Deshmitem:

2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Ndërsa, OE UP LIFT ka prezantuar Diplomen dhe CV, vetëm për 1 teknik të ndërtimtarisë, me saktësisht z. Fadil Hasani. Pra, OE i shpallur fitues nuk ka përmbushur kërkesën në DT për aftësi profesionale dhe teknike.

Në përgjigjen e AK, AK arsyetohet se për pikën C nuk është kërkuar asnjë deshmë, gjë që nuk qëndron, pasi që në DT tek deshmitem është e cekur pika 2, pra deshmitem e kërkuara vlejnë për kërkesën e pikës 2 ku përfshihet i gjithë stafi (inxhinierët dhe teknikët). Gjithashtu është shumë e paqarte për ne se si mund të deshmohet Profesioni dhe përvoja e punës pa diplomë dhe pa CV.

Argumenti 2)

OE i shpallur fitues, ka prezantuar ISO certifikatat e kerkuara tek **"Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale"**, mirepo keto certifikata jane te leshuara dhe valide me daten 18.05.2023 (pra vetem 1 dite para hapjes se tenderve").

Andaj, ky OE nuk ka deshmuar se i ploteson KËRKESAT MINIMALE TË KUALIFIKIMIT, perkatesisht: Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale deshmi te cilat duhet te jene faktike PARA Dates se Njoftimit per Kontrat.

Pra, ne qofte se OE "UPLIFT" nuk deshmon se ka plotesuar kerkesat para dates se Njoftimit per Kontrat, i njejti OE duhet diskualifikuar nga aktiviteti i prokurimit.

Argumenti 3)

Duke pasur parasysh se OE "UPLIFT" nuk ka plotesuar çmimin e : **B. PUNËT E ASHENSORIT - REKAPITULIM**, AK duhet ta eliminoje nga gara per mosplotesim te listes se cmimeve dhe per mungese te cmimit, pasi qe ky eshte **KUSHT ADMINISTRATIV**.

Me poshte gjenei paramasen e OE UPLIFT ku shihet se nuk ka plotesuar paramasen tek pika e lartepemendur.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "“ EJONA " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me numër të prokurimit: “616-23-3831-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

A. PUNËT NDËRTIMORE - REKAPITULIM					
POS. 1	PUNËT PREGADITORE				50.00
POS. 2	PUNËT DEMOLUESE				286.00
POS. 3	PUNËT E CHEUT DHE MBUSHJA				159.85
POS. 4	PUNËT E BETONIT, ARMATURES DHE HIDROIZOLIMIT				1,321.49
POS. 5	PUNËT ME ÇELIK (KAPRIATA LINEARE)				4,964.68
POS. 6	PUNËT E MVESHUES ME PANELE KOMPOZITE - ALLUKOBOND				7,025.00
POS. 7	PUNËT TJERA				2,166.20
TOTAL - PUNËT NDËRTIMORE:					15,973.22
B. PUNËT E ASHENSORIT					
Poz.	Përshkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi me TVSH (€)	Totali (€)
1	Vërejtje: Në bazë të kërkesës së investitorin duhet të instalohen ashensor elektrik (Q=630 kg, 8 persona) edhe të prodhuesve të fjerë që i plotëson kushtet sipas Ligji Nr. 06/L-041 Për				
1.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i ashensorit elektrik 630 kg për 8 persona sipas projektit detal (Kabina 1100x1400 mm; Dyert e Kabinit: 900x2000, cope 1 Automatik; Dyert për hyrje nga koridori 900x2000, 3 cope Automatik; Korniza e Kabinit; Makineri; Sistemi i Mbingarkesës; Bufeti për Kabinit-Amortuesi; Shinat për Kabina Lloji: 90x75x16; Rregullatori i Shpejtësis; frenat, invertori, sajlat, Ndriqueshmeria etj.	Copë	1.00	24,000.00 €	24,000.00
TOTALI POSICIONI:					24,000.00
B. PUNËT E ASHENSORIT - REKAPITULIM					
#REF!	PUNËT E ASHENSORIT				
TOTAL - PUNËT E ASHENSORIT:					
C. PUNËT ELEKTRIKE					
Poz.	Përshkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi me TVSH (€)	Totali (€)
1.2.1	Furnizimi dhe montimi i tabelës shpërndarëse elektrike për Përdhës (KSH-E-P). Me mbrojtje IP43, 36 modulsh, me këto elemente:	copë	1.00	10.00 €	10.00
1.2.2	Furnizimi dhe montimi i mbrojtjes diferenciale katërpolare me myma normale In=63A dhe myma diferenciale Idn=0.03A.	copë	1.00	10.00 €	10.00
1.2.3	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike trepolare me karakteristike veprimi C për myma nominale In=25A.	copë	1.00	10.00 €	10.00
1.2.4	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike njëpolare 1P+N me karakteristike veprimi C për myma nominale In=16A.	copë	10.00	9.00 €	90.00
2.2	Furnizimi dhe montimi i kablove energjetike NYM-J-Sa6mm² Cu, për furnizimin e ashensorit NEGOTIN ose të ngjashëm.	m	32.00	5.00 €	160.00
TOTALI PUNËT E ELEKTRIKËS:					280.00 €
RIKAPITULIM PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE NDËRTIMORE					
Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Shuma totale (€)			
A	PUNËT NDËRTIMORE	15,973.22			
B	PUNËT E ASHENSORIT	24,000.00			
C	PUNËT ELEKTRIKËS	280.00			
Totali pa TVSH:					34,112.90
TVSH 10%:					6,140.32
Totali me TVSH:					40,253.22
RIKAPITULIM PERFUNDMITAR					
RIKAPITULIMI I PARAMASE DHE PUNIMEVE PER ADAPTIMIN E ASHENSORVE NGA HIDRAULIK NË ELEKTRIK				Shuma:	103,000.00
RIKAPITULIM PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE NDËRTIMORE				Shuma:	40,253.22
				Totali me TVSH:	143,253.22



PËRFUNDIM:

Pas gjetjes se ketyre shkeljeve dhe pas argumentimeve se OE "UPLIFT" i shpallur fitues, nuk i plotëson kërkesat në DT dhe në Listen e çmimeve, kërkojmë nga OSHP që të anulohet vendimi dhe

dhenies, ta ktheje lenden ne rivleresim dhe te shpalle OE UPLIFT te eliminuar nga ky aktivitet.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme ne vlere minimale 180,000 euro ne tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrate.	1.Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te puneve.
		2.Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme a.Inxhinier i diplomuar ose bachelor i elektroteknikes. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar së paku 1 kontrate të natyrës së ngjashme. b.Inxhinier i diplomuar ose bachelor i makinerisë. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar së paku 1 kontrate të natyrës së ngjashme. c. 3 teknikë të ndërtimtarisë Minimumi 3 vite përvojë pune në punë.	2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë.
		3.Operatori duhet te jete i certifikuar sipas standardeve ISO 9001 , ISO 14001 dhe ISO 18001 .	4.Kopjet e certifikatave valide ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 18001.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

OE-ik "HYMERI ELEVATORS" L.L.C. nuk ka dorëzuar listen e projekteve, referencat apo certifikatat e per kryerje te puneve, nuk ka dorëzuar listen e stafit si dhe asnjë dokument lidhur me stafin e kerkuar nga Ak si dhe nuk ka dorëzuar kopjet e certifikateve valide ISO 9001 , ISO 14001 dhe ISO 18001 per arsyjet e cekura me larte refuzohet tenderi i tij.

TENDERUESI		Informata shpese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit
1.	Uplift L.L.C. 811856965	<p>OE-ik Uplift LLC I është kerkuar sqarim shpese si ne vijim : Ju me ofertën tuaj keni dorëzuar Referencat për punë të kryera si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Referencë (NR.Ref:12/05U të datës 12.05.2023 nga kompania “FIDOLA”SH.P.K.; 2. Leter Reference nga kompania “POZHEGU BROTHERS”; 3. Reference nga kompania “eng office”Sh.p.k <p>Bazuar ne nenin 72 të LPP-se kërkojmë nga ju qe të dorëzoni Kontratat e projekteve të lartë cekura ku në ato kontrata të jenë shumat e vlerave të kontraktuara sepse në referencat e bashkangjitura nga ana juaj nuk figurojnë shumat e kontratave.</p> <p>Ndersa OE-ik ne fjale ka ofruar sqarimin shpese brenda afatit kohor te parapare te cilat jane te pranueshme per komisionin e vleresimit.</p>
2.	" EJONA " SH.P.K. 810089913	
3.	ALFA.i 810298853	<p>OE-ik Alfa I është kerkuar sqarim shpese si ne vijim : Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:</p> <p>Ju me ofertën tuaj keni dorëzuar listën e kontratave mirëpo për aktivitetin me titull: -“Adaptimi, renovimi i shtypshkronjës për Agjencinë Kosovare te Privatizimit AKP” + (PLUS) Aneks kontrata, andaj bazuar ne nenin 72 te LPP-se kërkojmë nga ju qe te na dorëzoni kontratën me paramasë dhe parallogari për këtë aktivitet.</p>
		<p>-Për aktivitetin:“Ndërtimi i Qendrës Shkollës se Mesme ne Graçanicë” kërkojmë nga ju qe të na dorëzoni referencën apo certifikatën e kryerjes se punëve poashtu kontratën me paramasë dhe parallogari për këtë aktivitet.</p> <p>-Për aktivitetin: “Furnizimi dhe montimi i ashensorit ne objektin Swiss Bau; kërkojmë nga ju qe te na dorëzoni referencën apo certifikatën e kryerjes se punëve për këtë aktivitet.</p> <p>-Për inxhinierin e Elektros Bujar Aliu keni dorëzuar dokumentet si ne vijim : CV-ne , diplomën dhe Referencën mirëpo nuk keni dorëzuar Kontratën e punës me punëdhënësin ose Marrëveshjen mbi angazhimin për këtë projekt, andaj bazuar ne nenit 72 te LPP-se kërkojmë nga ju qe te na dorëzoni dokumentin e larte cekur.</p> <p>Ndersa OE-ik ne fjale ka ofruar sqarimin shpese brenda afatit kohor te parapare te cilat jane te pranueshme per komisionin e vleresimit.</p>
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik DESIGN LIFTS SH.P.K.; GSC SH.P.K.; AC ing SH.P.K.	
5.	"HYMERI ELEVATORS" L.L.C. 600236609	

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - " EJONA " SH.P.K.

Përgjigje në Pretendimin Nr.1:

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me kërkesat teknike profesionale sipas dosjes se tenderit është kërkuar: 2.Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të c. 3 teknikë të ndërtimtarisë Minimumi 3 vite përvojë pune në punë.

2. **CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.**Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë.

Eksperti shqyrtues vlerëson se sipas kërkesës AK-ja ka kërkuar qe të gjitha kërkesat të përfshijnë CV, diploma, kontrata të punës apo marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt. Pjesa tjetër e kërkesës ka të bëjë me kërkesat për Inxhinierë. Përgjigja e AK-se në kërkesën për rishqyrtim se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar të gjitha dëshmitë nuk qëndron sepse dëshmitë janë dorëzuar vetëm për një teknik të ndërtimtarisë me initiale F.H derisa me ofertën nuk janë dorëzuar të gjitha dëshmitë për teknikun e ndërtimtarisë G.M dhe N.S.

Bazuar në **Neni 59 Eksamini, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve – Paragrafi 4** Autoriteti kontraktues dotë konsiderojnë tenderin si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderin e fjalës është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit

1. AK-ja me datën 04.06.2023 ka kërkuar sqarime për ofertën e OE te rekomanduar për kontratë

por që nuk ka përfshirë ndonjë sqarim për kriterin 9.1 & 9.2, pra nuk e ka shfrytëzuar të drejtën sipas nenit 10 të UOPP dhe nenit 72 paragrafi 1 i LPP-se Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Prandaj duke u bazuar në sqarimet e mësipërme eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi **është i bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin Nr. 2:

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me vlefshmërisë e certifikatave ISO 9001, 14001 dhe 18001(45001) eksperti shqyrtues sqaron se certifikatat e dorëzuara me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë në ditën e dorëzimit të ofertës kanë qenë me validitet. Validiteti i certifikatave sipas dëshmive të dorëzuara me oferte janë – ISO9001 – valide deri 17.06.2026, ISO 14001 – valide deri 17.05.2026, ISO 45001 – valide deri 17.05.2026.

Për më tepër dosja e tenderit e specifikon se certifikatat duhet të jenë valide që nënkuptohet se kërkesa ka të bëjë me datën e dorëzimit të tenderit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues në këtë pikë **nuk është i bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin Nr. 3:

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me mosplotësimin e çmimit **B. PUNET E ASHENSORIT – REKAPITULLIM** dhe për këtë arsye duhet të eliminohet nga gara, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues i referohet gabimisht nenit 10 të UOPP për mungesë të çmimit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë në paramasën e dorëzuar me ofertë ka plotësuar të gjitha çmimet njësi sipas kërkesës së dosjes së tenderit, rekapitullimi që OE ankues i referohet është i bartur në totalin e përgjithshëm prandaj pretendimi i OE ankues se mungon çmimi nuk qëndron.

Prandaj bazuar në sqarimet e mësipërme eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor për këtë **nuk është i bazuar**.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **APROVOHET si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **" EJONA " SH.P.K.**

Burim Zeka

